

## NË EMËRTË POPULLIT

Gjykata Themelore- Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët: Gëzim Pozhegu si Kryetar i trupit gjykues, Diana Sina e Manduhije Syla anëtare të trupit gjykues, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.K. nga f.sh. C. K. e Gjakovës, për shkak të veprës penale: të Grabitje nga neni 329 parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vepruar sipas të akuzuar nga Prokuroria themelore Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, PP/I.nr.47/2014 të datës 02.05.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt. 23.08.2016, 30.08.2016, 30.09.2016, 05.12.2016 dhe 09.12.2016, në prezencën e të akuzuarit I.K. dhe mbrojtësit të tij av. N.D. nga Gjakova, Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, dhe kryetari i trupit gjykues publikisht me data 12.12.2016, Shpalli këtë

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari I.K.** i biri i B. dhe nenës D., e gjinisë Gj. i lindur me dt.... në f.sh. C. K Gjakovës, nr. Personal... ka të kryer shkollën e mesme , i martuar, baba I një fëmije i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar me parë.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Se:

Me dt. 10.03 2014, rreth orës 09:05 në Gjakovë, në Rr. " S. S." pikërisht në Mobil shopin" V "prone e **N.M.** me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm me përdorimin e forcës e sulmon trupin e të dëmtuarit **E.M.** dhe nga i njëjti ka marr telefonin Iphone 5 S Gold që kishte numrin nr.tel... në atë mënyrë që i kanë thënë " Pse me ke shajtur " dhe nga gjoksi ka kapur I mituri **F.U.** ndërsa i pandehuri **I.K.** e ka kapur për dore dhe e ka ulur në kauq, i mituri e ka kapur për fytyrë duke ja mbyllur gojën dhe nga xhepi ka marr telefonin Iphone 5 S Gold dhe I ka ra me një shkop në këmben e majtë e pastaj janë larguar nga vendi I ngjarjes dhe telefonin ia ka dhënë të pandehurit I.

- **me çka ka kryer veprën penale Grabitjes nga neni 329 par.1 pika lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Se:

Andaj, Gjykata konform neneve 6,17 al 1,41,43, al 3, 46, 51, 73, 83 nenin 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe neneve 359 par.2, 365, 366, 450 të KPPK-së, të akuzuarin e

## G J Y K O N

ME DENIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 200 (DYQIND EURO) të cilin dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

dhe

DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 1 (një) viti, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.03.2014 e gjer me datë 10.04.2014.

Kështu që në bazë të nenit 51 par. 1 dhe 2 të KPRK-së,

i shqiptohet,

### DËNIM ME KUSHT

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, që i' u është shqiptuar të akuzuarit I.K. nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari I.K. në afat prej 3 (tre) viteve nuk do të kryejë vepër tjetër penale.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti dënim do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve duke iu llogaritur 20,00 (njëzetë) € për një ditë burgim.

Në kuptim të nenit 450 par.1 të KPK-së, i pandehuri obligohet të paguajë shpenzimet procedurale penale në shumë prej 25 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 euro e cila duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit

Pala e dëmtuar për kompensimin e dëmit material dhe jo material udhëzohet në kontest civilo-juridik.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të rënda ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.47/2014, të dt. 02.05.2014, me të cilën aktakuzë të akuzuari I.K. i vihet në barrë se me veprimet e përshkruara si në dispozitiv të aktakuzë në bashkëkryerje ka kryer veprën penale të Grabitjes nga neni 329 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në seancën fillestare të mbajtur në Gjykatën Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me dt.30.08.2016, i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë.

I akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancën e mbajtur me dt.30.08.2016, para trupit gjykues, është deklaruar i pafajshme, ku pas kësaj, kryetari i trupit gjykues ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor në të cilën shqyrtim ka vendosur lidhur me kërkesën penalo-juridike të prokurorit të shtetit me përmbajtje si në aktakuzën e parashtruar.

#### FJALA HYRËSE

**Fjala hyrëse e prokurorit të shtetit Agron Matjani, i cili deklaron :**Aktakuza e ngritur kundër të akuzuarit I.K. nga f.sh. C. ,K. e Gj. për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, përmban prova të mjaftueshme që do të dëshmojnë se i akuzuari ka kryer këtë veprë penale, si provë për këtë është deklarata e të miturit F.U. deklarata e të dëmtuarit E.M. si dhe mbrojtja e të akuzuarit I.K. , po ashtu edhe nga i akuzuari I.K. nga ana e personave zyrtar-policëve është sekuestruar telefoni i markës Iphone 5SGold.

**Fjala hyrëse e të dëmtuarit E.M. i cili deklaron:** se sa i përket fjalës hyrëse sa i përket anës time i akuzuari nuk është fajtor, çka do të vërtetohet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

**Fjala hyrëse e mbrojtësit të akuzuari I.K. av. N.D. i cili deklaron se:** Mendojmë se provat e që do të administrohen gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor nuk do të vërtetojnë pretendimin e aktakuzës së ngritur nga ana e prokurorit të shtetit.

**Fjala hyrëse e të akuzuarit I.K. i cili deklaron:** se pajtohem me fjalën hyrëse të mbrojtësi tim dhe nuk kam çka të shtojë tjetër.

#### FJALA PËRFUNDIMTARE

**Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaron se .:**

Me provat e administruara në shqyrtimin kryesor u vërtetua se i akuzuari I.K. në bashkëkryerje ka kryer të veprës penale: të grabitjes nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , dhe se kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëgjimi i të dëmtuarit E.M. të dëshmitarit N.M., dëshmitarit F.U. nga vërtetimi mbi konfiskimin e telefonit, dhe kthimin e tij të dëmtuarit,. Sa i përket gjendjes faktike është vërtetuar se i akuzuari I.K. ditën kritike ka qenë së bashku me të miturin F.U., dhe se kanë shkuar së bashku në Mobil shop V. pronë e N.M. i mituri F.U. me vete ka pas edhe një shtagë të vogël, të cilën e ka pas në këmbë, dhe pasi që ka hi në lokal me forcë ka marrë telefonin nga xhepi i të dëmtuarit E.M. dhe atë telefonin Iphon 5S Gold me nr. kartel ... dhe pasi që ka marrë telefonin me atë shtagë i ka mëshuar në këmbën e majtë të dëmtuarit, dhe së bashku me të akuzuarin I.K. janë larguar nga vendi i ngjarjes, telefonin e marrë F. ia ka dhënë I.K. ku policia më vonë të njëjtin telefon e ka sekuestruar dhe i njëjti iu është kthyer të dëmtuarit. Sa i përket tezës së të dëmtuarit I.K. se atë ditë rastësisht e ka takuar të miturin F.U. në Mobil shopin V. këtë mbrojtje të akuzuarit gjykata nuk duhet ti kushtojë besim, pasi që i akuzuari me këtë mbrojtje mundohet ti shmangët përgjegjësisë juridiko-penale, e sidomos faktin se telefoni i vjedhur nga i dëmtuari E.M. është gjetur tek i akuzuari I.K. dhe se qëllimi i tij ka qenë përfitimi i kundërligjshëm pasuror.

Andaj propozoj që trupi gjykues të akuzuarin I.K. ta shpalli fajtor për veprë penale të grabitjes nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe ti shqiptojë dënim sipas

ligjit, gjatë caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata duhet të ketë parasysh faktin se i akuzuari është për herë të parë në gjykatë, më herët nuk është ndeshur me ligjin, dhe faktin se telefoni Iphon 5S Gold iu është kthyer të dëmtuarit E.M. Po ashtu gjykata duhet të obligojë të akuzuarin I.K. që të paguajë shpenzimet gjyqësore.

**Në fjalën përfundimtare i dëmtuari E.M. deklaron:** se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe se nuk kërkon kompensim të dëmit material.

**Mbrojtësi i të akuzuarit I.K. av. N.D. në fjalën e tij përfundimtare deklaron :**

Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u administruan të gjitha provat, gjykata i patë në disponim të propozuara nga ana e palëve, në fund e dha mbrojtjen edhe i akuzuari I. i cili në mbrojtjen e tij mohon në tërësi veprën që i vihet në barrë. Mbrojtja e të pandehurit është shumë e qartë, bindëse dhe mbështetur në të gjitha provat tjera që u administruan prandaj gjykata mbrojtjes së tij duhet t'ia falë besimin. Realisht prita që Prokuroria do të heq dorë nga kjo akuzë, megjithatë nuk po befasohem me qëndrimet e prokurorit, ku kryekëput kjo çështje penale bënë shkeljen e ligjit të procedurës penale në dëm të akuzuarit, pretendimi i Prokurorisë nuk është i mbështetur në asnjë provë, çak është në kundërshtim të tërësisht me interesat e palëve të dëmtuara. Ne dëgjuam të dëmtuarin i cili ka më së paku interes që të kontribuojë në mos ndriçimin e rastit, sepse është edhe palë e dëmtuar, i cili kjo s'është se i akuzuari I. në asnjë mënyrë nuk është i involvuar as si kryes apo bashkëkryes apo ndonjë formë tjetër e veprës penale, siç është ndihma, apo fshehja e mallit e siguruar me vepër penale. Në të njëjtën mënyrë deklarojë edhe dëshmitari F. i cili prezencën e këtu të akuzuarit ditën kritike në vendin e ngjarjes e sheh vetëm si rastësi, e në fund të fundit këta janë fqinjë dhe bashkëfshatarë dhe për shkak të një situate të tij dhe raporti që ka me të nuk do të thotë se ky do të jetë kryes, këta janë vetëm fqinjë, mbrojtja mendon se pretendimet e prokurorisë nuk janë vërtetuar kanë ngelur vetëm në nivelin e supozimeve, ashtu siç ka filluar hetimi, kështu që gjykatës i propozojë që të merr aktgjykim lirues për të mbrojturin tim I.

**I akuzuari I. në fjalën përfundimtare deklaron:** se pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Gjykata pas administrimit vlerësimit të provave të administruara një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën dhe me provat tjera në kuptim të nenit 361 të KPPK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike

si vijon, pas kësaj ka konstatuar se e akuzuari I.K. ka kryer veprimet e përshkruara si në dispozitivin e kësaj aktakuze dhe se më këtë në bashkëkryerje ka kryer të gjitha elementet e veprës penale : nga neni 329 parag.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së ,për të cilët është shpall fajtor, nga arsyet si në vijim:

Në procedurën e provave prokurori shtetit në cilësinë e dëshmitarëve i ka dëgjuar : F.U. N.M. dhe të dëmtuarin - dëshmitarin E.M. dhe provave materiale: - deklarata e të pandehurit I.K. deklarata e të miturit F.U. deklarate të dëmtuarit E.M. lista -zinxhirit të ruajtjes , raporti të oficerit, fotoalbumit me numër të

rastit 2014-DB-382, dt. 10.03.2014 dhe raportit të SR "Isa Grezda" nr.2426, datë 10.03.2014 për të dëmtuarin E.M.

Me shqyrtimin e provave është vërtetuar se rasti inkriminuesi I.K. ka ndodhur me dt. 10.03.2014 rreth orës 09:45 min., ku me dashje ka sjellë vetit përfitim pasuror të kundërligjshëm lokalit e - Mobil - shopin " V" rr. " S.S" në Gjakovë, ku së bashku me të miturin F. me përdorimin e forcës e sulmon trupin e të dëmtuarit E.M. dhe nga i njëjti ka përvetësuar telefonin Iphone 5S Gold që kishte nr... në atë mënyrë që i mituri F.U. e ka kapur për gjoksi ndërsa i akuzuari I.K. e kapur për dore dhe e ka ulur më kauq, ku i mituri e ka kapur për fytyrë duke ja mbyllur gojën dhe nga xhepi ka marr telefonin Iphone 5S Gold dhe i ka ra me shkop në këmben e majtë e pastaj janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe telefonin ia ka dhënë të akuzuarit I.

### **Procedura e provave**

#### **Dëshmitari-F.U.**

Dëshmitari-F.U. pasi u njoftua me të drejtat e tij deklaron dhe japi betimin deklaron:

Se me dt. 10.03.2013 kam qenë në shitoren Mobil shop "V" në Gjakovë, rastësisht kam takuar I. edhe e kam marrë me veti, mandej jemi shkua tek Mobil shop, unë jomë hi i pari në dyqan, kurse mandej I.

Në dyqan me I. shkova, sepse me E. i kisha disa probleme më herë, problemin e kam cekur edhe në seancën e mëparshme ku jam gjykuar në Departamentin për të mitur, problemi ka qenë zinxhiri i arit. Unë zinxhirin e arit ia kam pas shitur E. ndërsa ai nuk mu ka përgjigjur me pare dhe atë ditë kam shkua për këtë çështje në lokalit e tij.

Ia kam dhënë zinxhirin në këmbim për një telefon të cilin telefon E. nuk ma ka dhënë, nuk jemi marrë vesh për llojin e telefonit.

Atë ditë kam shkua me u marrë vesh me te dhe duke folur lindi problemi dhe unë e kam goditur E. me shkop të drurit, të cilin shkop më të gjatë, të cilin shkop e kam marrë nga shtëpia. Shkopin e kam pas në çantë.

Kur hyra në dugoje në dugoje ka qenë vetëm E.

Telefonin E. e ka pas në xhep, ia kam kërkua telefonin, pasi që ma ka dhënë telefonin e kam goditur, në këmbë e kam goditur. Në momentin kur isha në dyqan I. ka qenë te dera, nuk ka hy brenda dhe nuk më ka ndihmuar.

Kur e mora telefonin kemi shkua në shtëpi së bashku me I. kur kemi arritur në shtëpi unë ia kam dhënë telefonin I. I. u. k. e ka ditur që unë e kam marrë telefonin.

Telefonin, ia kom jap me e mbajt se unë nuk kam shkua fare në shtëpi, jam nisur për Gjakovë dhe telefonin ia kam dhënë me ma mbajt përderisa të kthehem nga Gjakova.

Në Gjakovë kam shkua se më kanë thirrë në Polici, për atë arsye kam shkua në Gjakovë. Zinxhirin e arit, e kam pas dhuratë nga nëna për ditëlindje , këtë e kam cek edhe në deklaratën e dhënë në Gjykatë me rastin e gjykimit tim si i mitur.

E.M. e kam njohur edhe para se me e ndërruar zinxhirin e arit, kam njohur në shkollën e mesme.

Te E., shkova me ja shit zinxhirin e arit dhe nuk shkove tek ndonjë argjendari tjetër për arsye se nuk kam qenë i informuar se mundem mi shitë dikund tjetër.

Në pyetjen e dëshmitarit- dëmtuarit E. : A jam kon unë në shkollë të mesme?.

Dëshmitari F. përgjigjet.: Jo ti nuk ke qenë në shkollë të mesme, por je ardhë kah shkollat e mesme dhe je cell disa herë. Nuk është e vërtetë se kam thënë se jam në shkollë në Pejë , E. e ka ditë që jam në shkollë të mesme në Gjakovë, më ka pa duke dal nga shkolla, unë kam qenë në Shkollën e Mesme Ekonomike.

Nuk është e vërtetë se kam ardhur në dyqan dhe i kam thënë :Pse me ke shajtë dhe llabutin e kam nxjerrë prej mangës së dorës?

I dëmtuari E. bënë vërejtje në dëshminë e dëshmitarit F. dhe cek se nuk e ka thënë të vërtetën se si ka ndodhur ngjarja, se nuk është e vërtetë se jam kam marr zinxhirin, shkollën e mesme unë nuk e kam vazhduar dhe nuk kam pas arsye për me u cell afër shkollës, e vërtetë është ajo se çka tha për I. aty nuk kam vërejtje .

### **DËSHMITARI - i dëmtuari E.M.**

Dëshmitari – dëmtuari E.M. pasi u njoftua për të drejtat e tij dhe jep betimin deklaron:

Është e vërtetë se kam dhënë deklaratë në prokurori me dt. 07.04.2014, dhe mbetem pranë asaj deklaratë.

Me dt. 10.03.2014, telefonin Iphon 5 Gold, ma ka marrë F.

F. para se të ma merrte telefonin ka qenë 4-5 herë me shoqëri në dyqanin tim ku shesim telefona, herën e fundit ka ardhur me I. me ç’ rast I. vetëm ka qëndruar te dera dhe nuk ka tentuar që t’ ma merr telefonin, por telefonin ma ka marrë F.

F. nuk i kom pasur borxh, F. nuk e kam njohur përpara dhe vetëm ka ardhur 4-5 herë gjëja se po donë me ble telefon, por nuk ka blerë asnjëherë.

F. erdh në dyqan më tha : Pse më ke shajtur? Dhe më kapi për dore, më mëshojë me llabut, ma mori telefonin dhe iki, kurse I. ndejti tek dera.

Nuk e di, se i akuzuari I. ka ardhur së bashku me F. ky ka qëndruar tek dera, nuk e di se a ka ardhur me F. Kur kam qenë i ulur në kauç, nuk më ka kapur për dore I.

Telefoni i vjedhur më është kthyer.

Në pyetjen e mbrojtësi i të akuzuari I.K. av. N.D.

Thatë se I. ka qenë te derra, dhe se F. ta ka marrë telefonin, a ke dëgjuar ti nga i akuzuari I. ndonjë kërcënim për dhënien e telefonit?

Dëshmitari përgjigjet: Jo nuk kam dëgjuar absolutisht asnjë kërcënim nga I.

Av. N. : A të kujtohet se I. a ka qenë brenda në lokal apo jashtë lokalit?

Dëshm. (E.M.): Nuk ka qenë brenda por ka qenë duke hyrë në lokal.

Pas largimit të F. , asnjë fjalë kërcënuese nuk kam dëgjuar nga I. dhe asnjë kontakt fizik me I. nuk kom pasur.

### **DËSHMITARI N.M.**

Dëshmitari - dëmtuari E.M. pasi u njoftua për të drejtat e tij dhe jep betimin deklaron:

Prej djalit të dëmtuarit E. për I. nuk kam dëgjuar se I. është i involvuar në atë grabitje, nuk më ka thënë , më ka thënë për atë tjetrin por emri i tij nuk më kujtohet .

Unë kam shitore për shitjen e telefonave , firmën dyqani im e ka “ V” , këtë shitore e kam që 4 vite.

Ditën kritike me dt. 10.03.2014 në shitore ka punuar djali im E.

Për rastin u njoftova pasi që isha afër dhe pas policinë që kishin ardhur në lokal, ku ishte edhe djali im E.

Ditën kritike djali im E. ka pasur lëndim në këmbë, po për këtë ka qenë edhe te mjeku.

Djali më tregoi se lëndimet i ka shkaktuar ai personi tjetër, që thash më parë- i mituri, jo ky këtu që është i akuzuar.

Çka atë ditë prej dyqanit tim është marrë Telefoni Iphon 5Gold i cili në atë kohë ka kushtuar 700,00 €.

Telefoni na është kthyer nga ju-prokurori.

Mbas ditës kritike i mitur F. nuk ka qenë në dyqanin tonë

Më herët me këtu të akuzuarin I.K. nuk kemi pasur asnjë problem.

## **PROVAT MATERIALE**

Në raportin e oficerit , fotoalbumit me nr. rastit 2014-DB-382 të dt. 11.03.2014, Xh. S. është konstatuar se rasti grabitjes ka ndodhur ditën kritike 10.03.2014, në orën 09:05, në vende të ngjarjes kanë takuar të dëmtuarin E.(N).M dt. lindjes... në Gjakovë, i cili ishte duke punuar në dyqanin e babait të tije dhe rreth orës 08:20 kishin ardhur dy persona të rinj në moshë 18 vjeçare dhe i kishin thënë " perse me ke shajt dhe me pas i kishin rënë me një send të fort në këmbën e majtë dhe i kishin marr telefonin IPHONE 5 S GOLD" i cili kishte numrin në të ... nga xhepi dhe kishin ikur në drejtim të panjohur . Sipas viktimës njërin nga ta kishte ardhur në dyqan disa herë për të këqyr telefona së bashku me një shok të tije të cilin e njeh edhe viktimja i cili quhej E.D. Sipas viktimës vlera e telefonit ishte 550 Euro. I njëjti thotë se e njeh personin si figurë dhe mund ta identifikoj dhe i dëmtuari ka marr tretman mjekësor në emergjencë nr. Raportit 2426.

Në vendngjarje kanë ardhur njësia e hetimeve me Rresh. K. H. , Rresh. Sh. N. dhe hetuesi D.B. cilët kanë marrë viktimën me veti dhe kanë dalë në kërkim të dyshimëve si dhe kanë njoftuar Kryeprokurorin.

Fotoalbumit me numër të rastit 2014-DB-382, dt. 10.03.2014 .

Në bazë të fotoalbumit, i cili mban numrin e forenzikës FGJ-14-79, të cilat foto janë fotografuar me Fotoaparatin Model Digjital "Canon" dhe " Sony" tregojnë vendin e ngjarjes dhe objektet për rreth , lokalin ku është kryer vepra penale dhe telefonin e grabitur nga viktimja.

Raportit i SR "Isa Grezda" nr.2426, datë 10.03.2014 për të dëmtuarin E.M. ku shihet se i dëmtuari është vizituar në Spitalin regjional " Isa Grezda " në Gjakovë, ku edhe ka marr ndihmën mjekësore.

## **MBROJTJA E TË AKUZUARIT**

Pasi që i akuzuarit u përkujtua për të drejtat e tij, i akuzuari I.K. deklarohet lidhur me rastin.

Në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësi av. N.D. të mbrojturit të tij të akuzuarit I.K.

I akuzuari deklarohet:

Se me dt.11.03.2014, ka dhënë deklaratë rreth rastit, dhe se i kujtohet se çka ka deklaruar dhe se nuk ka çka të shtojë më tepër.

Ditën kritike kam qenë me F. në dyqanin e E. nuk më ka njoftuar F. se për çka po shkoni tek E.

Kur ma ka lënë telefonin më ka thënë : nëse e takon ndonjë person të familjes time ia jep telefonin, nëse jo ia qon ma vonë telefonin.

Nuk kom pas shoqëri me F. veç se kemi qenë në të njëjtën shkollë fillore në fshatin C. Më kujtohet se me F. jemi takuar rastësisht tek dugoja.

Nuk kam hi brenda në dyqan, kam qëndruar te dera, dhe kam qenë i habitur , nuk kam ditur se çka është ka ndodh.

Jam ndal të dera se kam qenë i habitur, se krejt kjo ka ndodhur shpejt, e unë thjeshtë nuk kom di se çka o ka bohet dhe jam habit.

Sa më kujtohet E. ka qenë larg nga dera nja 1m deri 1,50cm.

E.F. e ka goditur në këmbë, dhe nuk e kom pa kur ia ka marrë telefonin nga xhepi.

Pasi iku F. kam qëndruar prapë aty edhe disa minuta, aty u bo tollovi dhe u largova.

Me F. jam takuar prapë në autobus, nuk kemi qenë së bashku të ulur, kemi qenë veçmas.

Telefonin F. ma dha mbas nja 15 minutave rrugë me autobusë , ku F. ishte ulur në fund të autobusit, më thirri dhe më tha.: që t' ia mbajë telefonin dhe nëse e sheh dikë të shtëpisë së tij t' ia jep telefonin, nëse nuk e sheh askënd të shtëpisë së tij , atëherë telefonin Iphon 5S t' ia dërgojë në shtëpi.

Nuk e kom pyetur F. për ndodhin në dyqan, pse u kacafyte me E.

Ai ma dha telefonin mua me e dorëzua, e nuk shkojë vet në shtëpi me e dorëzua pasi e kam dëgjuar se dikush ka fol me vozitësin e autobusit, e ku më vonë kam marrë vesh se ka qenë babai i F. dhe i kanë thënë : F. që menjëherë të kthehet në Gjakovë se po e kërkon policia, për këtë arsye F. ma ka dhënë telefonin mua?

Pastaj telefonin e kam vendosur në raft në shtëpinë time, dhe se ndërkohë kam shkuar ti ndihmojë prindit rreth bujqësisë, pastaj prindin tim e kanë thirre policia në telefon , dhe i kanë thënë : Se a është I. me ty?, baba iu është përgjigjur : Se po është me mu dhe i kanë thënë që merre djalin dhe telefonin dhe hajde të paraqiteni në polici. Kur shkuam në polici telefonin e mori policia, dhe më morën në pyetje lidhur me rastin e ndodhur. Telefoni ka qenë ngjyrë ari , tipi ka qenë Iphon 5S Gold.

Telefonin që ma dha F. Nuk ia qova në shtëpi te F. ky është gabimi im, se së pari jomë paraqitur tek prindi e nuk kam shkuar menjëherë me ia qua telefonin në shtëpi.

Mbas kësaj nuk jam takuar me F. nuk kom pas kontakt me to.

Kjo Gjykatë ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit, të cilës nuk ja fali besimin në tërësi . Përkatësisht, nga mbrojtja e të akuzuarit I. është konstatuar se i akuzuari I.K. së bashku me të miturin F. kanë ardhë nga fsh. C. K. Gj. në Gjakovë, pasi të dytë janë nga i njëjti vend përkatësisht nga fsh. C. dhe janë njohur edhe më parë pasi siç deklaroi edhe vet i akuzuari këta kanë qenë në shkollë të njëjtë dhe i kanë shtëpitë afër njeri tjetrit , pra nuk është e vërtet kur thotë i akuzuari I. se " rastësisht jemi takuar afër lokalit " " V " ku është kryer edhe vepra penale , fakti tjetër është se i akuzuari I. ka qëndruar tërë kohën prag të derës , sikur mos të ishte edhe ku bashkëkryes me siguri do të lajmëronte policin ose të paktën do të largohej nga vendi i ngjarjes kur e ka pa se çka po ndodh në lokal me rastin e grabitjes së telefonit nga i dëmtuari E. arsye tjetër se I. ka qenë së bashku me të miturin F. është edhe fakti se këta së bashku janë kthyer në fshatin e tyre në C. me të njëjtin autobus, arsyetimi i të akuzuarit se ata nuk kanë qenë së bashku të ulur në autobus, do të thotë se ata janë ruajtur me qellim që mos të diktohen se janë së bashku, kjo mundë të vërtetohet më së miri nga fakti se këta kur kanë zbrit nga autobusi në fshatin C. deri në shtëpi kanë vazhduar rrugën së bashku, pasi shtëpitë e tyre i kishin afër njeri tjetrit, e çka është me rëndësi kur kanë shkuar afër shtëpive të tyre telefonin e ka marr me veti në shtëpi i akuzuari I.



E gjithë kjo është vërtetuar edhe nga procesverbali mbi marrjen në pyetje të miturit para prokurori të Departamentit për Mitur nën PPM.nr. 38/2014 më dt. 21.03.2014 dhe procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit E.M. para prokurori të Departamentit për Krime të Rënda nën PP/I.nr. 47/2014 më dt. 07.04.2014.

Me të gjitha këto veprime të akuzuarit I. dhe të miturit F. vijnë deri të konkludimi se i akuzuari I. dhe i mituri F. kanë qenë së bashku që kur janë nisë nga fshati i tyre C. K. Gj. kanë qëndruar së bashku në Gjakovë , e deri sa janë kthyer në fshatin e tyre në C. Që do të thotë se i akuzuari I. dhe i mituri F. në bashkryerje kanë kryer veprën penale të grabitjes së telefonit iPhone 5 S Gold, dhe të njëjtën e kanë kryer me paramendim dhe se për këtë veprë penale të kryer nga i akuzuari I. dhe i mituri F. ekzistojnë elementet e veprës penale të grabitjes .

Pasi që me kujdes dhe me ndërgjegje i ka vlerësuar të gjitha provat e aktakuzës dhe mbrojtjes një nga një dhe të gjitha së bashku , kjo gjykatë ka konstatuar se e akuzuara i ka kryer veprimet të cilat iu kanë vu në barrë me aktakuzë. Me veprimet përcaktuara i akuzuari ka realizuar të gjitha elementet e veprës penale Grabitjes nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Përkatësisht, Kjo veprë penale është delikt me elemente të dhunës dhe bënë pjesë në veprat penale të përbëra . Në rastin konkret i akuzuari veprën penale e kryen në momentin kur ka marr pjesë në grabitje dhe kur e ka përvetësuar telefonin iPhone 5 S Gold, të cilin e ka pas edhe në shtëpinë e tij, kur policia e ka ndaluar të miturin F. i cili i ka treguar policisë se telefonin e grabitur e ka i akuzuari F.

E akuzuara në rastin kritik ka vepruar me dashje direkte se ka qenë e vetëdijshme se bëhet fjalë për sende të huaja dhe se sendin e merr nga pronësia personi tjetër me qëllim që me përvetësim vetit ti sjell pasuri të kundërligjshme , e këtë në të vërtet e ka dashtë .

Këto konstatime të gjykatës nuk kanë ardhur në dyshim as me mbrojtjen e vet të akuzuarës dhe mbrojtësit të tij të cilët jo bindshëm dhe paargumentuar pretenduan se e akuzuara nuk e ka kryer veprën penale dhe se nuk ka pas për qëllim të përvetëson telefonin e caktuar.

Në bazë të gjithë asaj të lartcekur kjo gjykatë ka vërtetuar se i akuzuari I.K. në bashkryerje ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 340 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe pasi nuk ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, e ka shpallur fajtor për atë veprë penale dhe për të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me kusht. Me rastin e zgjedhjes- caktimit të sanksionit juridiko penal gjykata ka marr për bazë dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e rastit lëndor , kështu që në anën e të akuzuarit ka gjet këto rrethana lehtësuese, para se gjithash kur ka kryer veprën penale ka qenë i moshës 19 vjeçare do të thotë i moshës relativisht të re, sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale , sjellja e tij gjatë gjykimit ,posaçërisht vlen të theksohet kujdesi i prindit për të akuzuarin, se i akuzuari dhe baba i tij janë mbajtës të familjes njëmbëdhjetë ( 11) anëtarësh, se nuk ka ra ndesh me ligjin më parë. Pra kjo gjykatë nuk ka gjetur rrethana rënduese për të akuzuarën V.S.L.

Pasi kjo gjykatë nuk ka gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin I.K. gjykata duke zbatuar dispozitën e qëllimit të dënimit konform nenit 41 par. 1 të KPK-së, gjykata ka ardhur deri te përfundimi se në rastin konkret edhe me dënimin me kusht, konform

nenit 50 dhe 51 të KPRK-së, mundë të arrihet qëllimi i dënimit. Për këtë gjykata të akuzuarit I.K. për veprën penale i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200 ( dyqind euro) dhe dënimin më burg në kohëzgjatje prej një ( 1 ) vjet, me kusht që dënimi me burg në kohëzgjatje prej një ( 1 ) viti mos të ekzekutohet nëse e akuzuara nuk kryen veprën penale tjetër në afat prej tri ( 3 ) viteve. Gjkata ka gjetur se dënimi me burg në lartësinë e lartcekur është adekuat me natyrën dhe peshës së veprës penale të kryer , shkalës së fajësisë të akuzuarit posaçërisht rrethanave nën të cilat është kryer vepra, kështu që edhe më këtë dënim në rastin konkret mund të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit në bazë të nenit 41 të KPRK-së .

Në bazë të dispozitës nga neni 463 të KPP-së, i dëmtuari, lidhur me kërkesën pronësore juridike udhëzohet në kontest civil për të realizuar kompensimin e dëmit material.

Gjkata në bazë të dispozitës nga neni 450 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPK-së pasi që e ka shpallur fajtorë, e ka obliguar të dënuarën në bartjen e shpenzimeve të procedurës penale, për shpenzime në emër të paushallit gjyqësor 25 euro, dhe në emër të shpenzimeve procedurale 25 gjithsejtë 50 euro dhe është e obliguar që të paguajë në afat prej 15 ditësh , pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nga gjithë ajo çka u parashtrua, kjo gjykatë duke vlerësuar dhe të gjitha provat e parashtruara , ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE - Departamenti për Krime të Rënda Gjakovë  
PKR.nr.84/2014 datë 12.12.2016

Sekretarja juridike,

Arbënore Basha

Kryetari trupit gjykues-Gjyqtari,

Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë në afat prej 15 ditësh duke llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit , ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes **kësaj gjykate**.